



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 888 Prot.

Tiranë, më datë 18.09.2020

VENDIM

Nr. 331, datë 14.09.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 14.09.2020,

VENDOSI:

- Miratimin e projektit - idesë për “Rehabilitimin e Qendrës Mesjetare të Beratit”, me aplikues TIKA, variantet e përzgjedhura për vazhdimin me projekt zbatimin janë:
 - Për stolat – varianti me gurë masivë reversibël;
 - Për koshat – varianti prej guri;
 - Për tabelat informative – varianti 2 në shesh dhe varianti 1 (foto e mesit në prezantim) para çdo objekti;
 - Për ndriçimin – varianti 3 i paraqitur dhe në rendera;
 - Për stolin përreth pemës – varianti i gjithë me dru;
 - Për murin e jashtëm rrethues – të jetë vetëm prej guri;
 - Të paraqitet plani i shtrimit të sheshit me detaje të qarta;
- Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
- Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR
Elva MARGARITI

